



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 538/23
Dt. 05.07.2023

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “ Elektro Plus “sh.p.k. me seli në Vushtrri, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar më dt. 26.06.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, më datën 05.07.2023 bie këtë:

V E N D I M

- 1. Apropohet si pjesërisht e bazuar Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë : “ Elektro Plus “sh.p.k. me seli në Vushtrri, e datës 03.07.2023, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër vendimit mbi Njoftimin e Autoritetit Kontraktues të datës 26.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit : “ Furnizimi dhe instalimi i monitorit LED “ me nr. të prokurimit : Nr. Prok: VU644 – 23 – 3917 – 1-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 037 – 121**
- 2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së do të vazhdoi me ri vlerësim të aktivitetit të prokurimit.**
- 3. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.**

A r s y e t i m

Me vendimin e sajë, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka marrë vendim që , në aktivitetin e prokurimit : “ Furnizimi dhe instalimi i monitorit LED “ me nr. të prokurimit : Nr. Prok: VU644 – 23 – 3917 – 1-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 037 – 121 , të shpërblej me kontratë Grupin e O.R. : “ Future Bits “sh.p.k. & “ Deko Solution L.L.C. “ me seli në Prishtinë.

Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga Op. Ek. “ Elektro Plus “sh.p.k. me seli në Vushtrri (në tekstin e mëtejme Ankuesi) e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo diskriminimi, neni 27 – Dosja e Tenderit dhe neni 57 – Sigurimi i Tenderit.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimi të provave në shkresat e lëndës, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është e bazuar për arsye se: në dosjen e tenderit, në pjesën Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE të Tenderit (FTD), nenin 13.1 – Siguria e Tenderit, është saktësuar se kërkohet Siguria e Tenderit pa u specifikuar të dhënat tjera të domosdoshme , si vlera dhe vlefshmëria e Sigurisë së Tenderit ndërsa, në Njoftimin për Kontratë të aktivitetit të prokurimit të njëjtë, publikuar më dt. 28.04.2023, në nenin IV.3.4 është saktësuar se : Siguria e Tenderit nuk është e nevojshme , pra nuk kërkohet të dorëzohet me Dosjen e Tenderit. Sikurse konstaton dhe A.K. me rastin e publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit , nuk është përmbushur kërkesa nga neni 27 pika 4 , citat : “ Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë duhen të jenë identike “ mbarim i citatit. Kjo përbën devijim substancial nga

kërkesat ligjore, krijon paqartësi dhe pasiguri tek O.E. dhe mundësi për trajtim të pabarabart të O.E. si dhe potencialisht vendimi i A.K. përbën apo mundë të përbëj shkelje të një dispozite të LPP-së.

Megjithatë kjo çështje nëse konsiderohet e nevojshme për rishqyrtim mbetet të interpretohet gjatë procesit të rivlerësimit të tenderëve.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik është vendosur si në dispozitiv te këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 037/2023, datë 05.07.2023

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj